




REPUBLIKA E MAQEDONISË
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale



KRIJIMI I TË ARDHMES SË PËRBASHKËT



IPA PROGRAMI PËR BASHKËPUNIM NDËRKUFITAR REPUBLIKA E MAQEDONISË - REPUBLIKA E SHQIPËRISË 2014 - 2020

Ky projekt është financuar nga Unioni European



M-r Lirim Shabani

Ministër

i vetëqeverisjes lokale

Të nderuar,

Raportet e mira fqinjësore janë vitale për vendet që kanë qëllim avancimin drejt antarsimit në UE, prandaj edhe Maqedonia është përkushtuar në përmirësimin e raporteve të mira me fqinjët dhe bashkëpunimin me vendet e rajonit.

Në këtë drejtim, kam kënaqësinë që përmes këtij publikimi, të prezantoj mundësinë që programi i ri IPA II 2014-2020 ofron. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ministria e Integritimit European janë në fazën përfundimtare të IPA Bashkëpunimit Ndërkufitar 2007-2013 dhe me sukses kanë mbështetur 51 projekte, të cilëve u janë ndarë grante në shumë totale prej mbi 7,2 milion Euro, fonde për përfituesit nga të dy vendet.

Përfaqësues të të dy autoriteteve kombëtare dhe strukturave të përbashkëta të menaxhimit patën mundësinë që të jenë pjesë e procesit të programimit dhe të paraqesin rezultatet e programit të mëparshëm, si dhe të prezantojnë sfidat dhe rezultatet e proceseve konsultative për programin e ri. E gjithë kjo rezultoi me përfundim efikas të procesit të programimit dhe aprovim i programit të ri nga UE u bë më dhjetor të vitit 2014.

Është paraparë që në periudhën 2014 – 2020 ky program të kontribuojë drejt avancimit të punësimit, fuqisë punëtore, lëvizshmërisë dhe përfshirjes sociale dhe kulturore në rajonin ndërkufitar. Për më tepër, në vazhdim janë prioritetet tematike për të cilat të dy vendet kanë rënë dakord:

1. Nxitje e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore (të udhëhequr nga mundësia);
2. Përmirësim i konkurrencës, ekonomisë, tregtisë dhe investimeve (të udhëhequr nga nevojat dhe mundësitë);
3. Mbrojtja e mjedisit jetësor, promovim i përshtatjes së ndryshimeve klimaterike dhe migrimit, parandalim i rreziqeve dhe menaxhimi (të udhëhequr nga nevojat).

Integrimi në UE është prioriteti kryesor i çdo vendi në Ballkanin perëndimor, jo vetëm që ato vende i përkasin Europës në kuptimin gjeografik, por edhe ngase Europa luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e reformave aktuale për transformimin e shoqërive të tyre përmes përfundimit të bazës demokratike dhe rritjes ekonomike.

Ju dëshiroj punë të suksesshme dhe bashkëpunim në të ardhmen.

Me respekt,

M-r Lirim Shabani



Klajda Gjoshja

Minister i Integritimit
Europian

Të nderuar pjesëmarrës,

Shqipëria mbështet fuqimisht idenë se pavarësisht vështirësive të hasura nga BE-ja në vitet e fundit, bashkëjetesa midis vendeve është në thelb të filozofisë së saj, kështu që së bashku ne mund t'ia dalim me sukses në kapërcimin e vështirësive duke u bazuar në bashkëpunimin tonë të përbashkët.

Duke patur parasysh faktin se Programi BNK përfaqëson një nga programet më të rëndësishme në të cilat Shqipëria merr pjesë dhe se marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë jetike për të dy vendet për të ecur përpara drejt anëtarësimit në BE, ne mbetemi të angazhuar për të çuar përpara marrëdhëniet e saj me fqinjët dhe bashkëpunimin me vendet e rajonit.

Objektivi janë për anëtarësimin në BE e bën të nevojshëm zgjerimin e bashkëpunimit mes dy vendeve tona, ku koordinimi i politikave të përbashkëta dhe mbështetjes së ndërsjellë për përmbushjen e objektivave tona dhe programet prioritare drejt integritimit në BE mbetet një proces i rëndësishëm. Jemi të angazhuar për të punuar me qeverinë, autoritetet lokale, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, për të garantuar që bashkëpunimi ynë i ardhshëm t'i shërbejë popullsisë së zonës së programit në të gjithë diversitetin e tyre.

Për sa i përket programit të ri BNK, përfaqësuesit e të dy autoriteteve kombëtare dhe strukturat e përbashkëta të menaxhimit kanë qenë pjesë një procesi të programimit dhe kanë prezantuar rezultatet e programit të mëparshëm, si edhe sfidat dhe rezultatet e proceseve të konsultimit për programin e ri. Rezultati i këtyre proceseve janë përfundimi i procesit të programimit dhe miratimi i dokumentit të programit të ri nga ana e Komisionit të Bashkimit Europian në dhjetor 2014.

Qytetarët tanë në të dy vendet, pavarësisht se ku jetojnë, dëshirojnë të kenë një ambient më të sigurt social, me mundësi të barabarta për secilin. Në këtë drejtim, objektivi i përgjithshëm i Programit të ri BNK është të nxisë një zhvillim socio-ekonomik më të balancuar, gjithpërfshirës dhe të qëndrueshëm të Zonës Kufitare.

Për të gjithë ne ky është një rast shumë i mirë për të qenë pjesë e bashkëpunimit tonë të ardhshëm.

Faleminderit që u bëtë pjesë e kësaj iniciative,

Urimet më të mira,

Klajda Gjoshja



Përmbajtja

<i>AKRONIME</i>	4
<i>SEKSIONI I: REZIME E PROGRAMIT</i>	5
1.1 Rezime e Programit.....	5
1.2 Procesi i programit dhe përfshirja e partnerëve	6
<i>SEKSIONI II: RAJONI I PROGRAMIT</i>	7
<i>SEKSIONI III: STRATEGJIA E PROGRAMIT</i>	9
3.1 Sqarimi – justifikimi i strategjisë së punuar për intervenime.....	9
3.2 Përshkrimi i prioriteteve të programit	11
<i>SEKSIONI IV: PLANI FINANCIAR</i>	17
<i>SEKSIONI V: STRUKTURAT E MENAXHIMIT TË PROGRAMIT</i>	19
5.1 Strukturat Organizative në nivel kombëtar	19
5.2 Strukturat Operative	19
5.3 Autoriteti Kontraktues	19
5.4 Komiteti i Përbashkët i Monitorimit	19
5.5 Sekretariati i Përbashkët Teknik/Antena	19

Ky publikim është përgatitur me ndihmën financiare të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e MVL/STP të IPA Programit për bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh qëndrimet e Unionit Evropian.



Akronime

BNK	Bashkëpunim ndërkufitar
CBIB +	Cross-border Institution Building
DP	Drejtoria e përgjithshme
UE	Unioni European
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
INSTAT	Instituti për statistikë i Republikës së Maqedonisë
IPA	Instrument për asistencë para-anëtarësimit
GPP	Grupi i Përbashkët Punues
SPT	Sekretariati i Përbashkët Teknik
NIPAK	IPA koordinatori kombëtar
NNJTS	Nomenklatura e njësive territoriale statistikore
SO	Struktura operative
SVM	Sipërmarrje të vogla dhe të mesme
SVOT	Analiza e fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve
PT	Prioritet tematik



Seksioni I: Rezime e Programit

Programi për bashkëpunim ndërkuftar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë do të zhvillohen në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimin (IPA II). IPA II mbështet bashkëpunimin ndërkuftar në drejtim të promovimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore, nxitjen e integritimit në union dhe promovimin e zhvillimit socio-ekonomik. Dispozitat juridike për zbatimin e tij janë dhënë në pjesët e mëposhtme të legjislacionit:

- Rregullorja (EU) Nr 231/2014 e Parlamentit European dhe Këshillit më datë 11 Mars 2014 që rregullon krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimin (IPA II);
- Rregullorja (EU) Nr 236/2014 e Parlamentit European dhe Këshillit më datë 11 Mars 2014 që përcakton rregulla dhe procedura të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të Unionit për financimit të veprimeve të jashtme dhe
- Rregullorja e Komisionit të UE për Implementim Nr 447/2014 më datë 2 Maj 2014 mbi rregullat specifike për zbatimin e rregulloreve të IPA II.

1.1 Rezime e Programit

Ky Program për Bashkëpunim Ndërkufi tar mbulon periudhën 2014-2020 dhe është lidhur me perspektivën e re fi nanciare të Unionit European. I njëjti është përcaktuar në bazë të një analize të ollësishtme të situatës në zonën e përfshirë nga programi.

Zona kufitare mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë karakterizohet si një nga zonat më të varfra dhe një nga zonat me kushtet më të pafavorshme dhe mundësitë për zhvillim socio-ekonomik në të gjithë kontinentin European për natyrën rurale, malore dhe të largët në fushën e bashkëpunimit ndërkuftar. Veç kësaj, zhvillimi i tanishëm i zonës së mbuluar nga Programi vjen nga një gamë faktorësh historik, demografik, politik, gjeografik dhe ekonomik të cilët nuk mund të tejkalohen në një periudhë të shkurtër kohe.

Ndërhyrja e propozuar dhe veprimet rrjedhin nga "pema e problemeve", e kombinuar me analizën strategjike të bilancit dhe të burimeve të kufizuara të Programit. Ajo ka për qëllim të adresojë problemet më të rëndësishme dhe mundësinë strategjike të identifikuar nga analiza socio-ekonomike dhe analiza SWOT, përkatësisht: i) nivel i ulët i aktivitetit ekonomik i shoqëruar nga një mospërputhje e ofertës dhe kërkesës në tregun e punës, ii) infrastrukturë të pazhvilluar dhe të vjetëruar dhe iii) kapacitet në zhvillimin e turizmit dhe shkëmbimit kulturor.



Nga pikëpamja reale, nuk ka pritshmëri që **Zona e përfshirë me Programin** të rritet shpejt, ndonëse **ka tendencë drejt një zhvillimi socio-ekonomik më të balancuar, gjithëpërfshirës** përmes testimit të instrumenteve dhe zgjidhjeve të reja, të mësuarit nga rajonet tjerë dhe mobilizim dhe shfrytëzim i potencialit endogjen. Kjo mund të sjellë deri te një standard më i lartë jetësor, vetëbesim dhe siguri sociale.

Programi fokusohet në tri prioritete tematike të Rregullores IPA II, që dalin nga analiza e nevojave dhe mundësi. Ata janë:

1. Nxitje e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore (të udhëhequr nga mundësia);
2. Përmirësim i konkurrencës, ekonomisë, tregtisë dhe investimeve (të udhëhequr nga nevojat dhe mundësitë);
3. Mbrojtja e mjedisit jetësor, avancim i përshtatjes së ndryshimeve klimaterike dhe migrimit, mbrojtje nga menaxhimi me rrezik (të udhëhequr nga nevojat).

Programi për bashkëpunim ndërkufitar përfshin edhe prioritetin për Asistencë Teknike.

1.2 Procesi i programit dhe përfshirja e partnerëve

Procesi i krijimit të këtij Programi për bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë nga IPA II filloi në korrik të vitit 2013. I gjithë drejtimi i programimit është bazuar në përvojën e përbashkët të procesit që është zhvilluar në periudhën 2007-2013.

Përpilimi i këtij Dokumenti të Programit është drejtuar nga një Grup i Përbashkët Punues i përbërë nga përfaqësues e të dy Strukturave Operative, përfaqësues nga IPA koordinatori kombëtar të të dy vendeve, përfaqësues të rajonit të programit NNJTS-3 rajone dhe disa njësi të vetëqeverisjes. Puna e GPP-së është lehtësuar dhe mbështetur përmes CBIB+ projektit për Asistencë Teknike e financuar nga UE, të cilët kanë sjellë praktika më të mira ndërkombëtare në këtë proces.

Seancat punuese të Strukturave Operative dhe GPP janë mbajtur gjatë gjithë fazës së përpilimit të programit në mënyrë që të sigurojë komunikim efektiv, që çon në identifikimin e Prioriteteve Tematike të cilat duhet të adresohen për zhvillimin e Strategjisë së Rajonit të Programit dhe vendosja e duhur e strukturave për zbatim dhe monitorim. Për më tepër, konsultimet mes SP-ve janë zhvilluar në kuadër të projektit CBIB+ për mësim dhe rrjetëzime.



Seksioni 2: Rajoni i Programit

Mbulimi gjeografik dhe madhësia e zonës së mbuluar nga programi rrjedh nga ndihma e mëparshme IPA për bashkëpunim ndërkufitar Republika e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë dhe mbulon tre NNJTS-3 rajone në çdo vend. Ato janë të shënuara më poshtë.

Rajone në Republikën e Maqedonisë	Madhësia e zonës së përfshirë në Program (km ²)	Zona e përfshirë në Program me % nga madhësia e vendit
Pellagonia	4.717	18,3
Rajoni jugperëndimor	3.340	13,0
Pollogu	2.416	9,4
TOTALI	10.473	40,7

Rajone në Republikën e Shqipërisë	Madhësia e zonës së përfshirë në Program (km ²)	Zona e përfshirë në Program me % nga madhësia e vendit
Korça	3.711	12,9
Dibra	2.586	9,0
Elbasani	3.199	11,1
TOTALI	9.496	33,0

Burimi: Enti për statistikë i Republikës së Maqedonisë, INSTAT

Madhësia e përgjithshme e zonës kufitare në të dy vendet është 19.969 km². Rajonet në Republikën e Maqedonisë përfshijnë 52,5% dhe rajonet në Republikën e Shqipërisë përbëjnë 47,5% të madhësisë në rajonin e bashkëpunimit ndërkufitar.

Popullsia e gjashtë rajoneve që përbëjnë zonën e mbuluar nga programi është 1.427.675 nga të cilat Republikës së Maqedonisë i atribuohet 54% të këtij numri, dhe 46% Republikës së Shqipërisë.¹

Rajonet e territorit të Republikës së Maqedonisë përfshijnë 27 komuna, ndërsa 12 zona (me 17 komuna) në territorin e Republikës së Shqipërisë. Së bashku përbëjnë zonën e përfshirë me Programin. Ata janë shënuar më poshtë (sipas alfabetit).

Në Republikën e Maqedonisë:

- **Rajoni i Pellagonisë** përfshin 9 komuna: Manastirin, Demir Hisarin, Dollnenin, Krivogashtanin, Krushevën, Mogillën, Novacin, Prilepin dhe Resnjën;

¹ Me fundin e vitit 2012; burimi: INSTAT dhe Enti për statistikë i Republikës së Maqedonisë



- **Rajoni i Pollogut** përfshin 9 komuna: Bogovinën, Brvenicën, Gostivarin, Jegunovcën, Mavrovën dhe Rostushën, Tearcën, Tetovën, Vrapçishtën dhe Zhelinën;
- **Rajoni jugperëndimor** përfshin 9 komuna: Qendrën Zhupa, Dibrën, Debarcën, Kërçovën, Makedonski Brodin, Ohrin, Plashnicën, Strugën dhe Vevçanin.

Në Republikën e Shqipërisë:

- **Qarku i Dibrës përfshin:** Bulqiza, Burreli dhe Rrethi i Dibrës;
- **Rajoni Elbasan përfshin:** Cerrikun, Elbasanin, Gramshin, Librazhdin dhe Peqini;
- **Rajoni Korçë përfshin zonat:** Devoll, Korçë, Kolonjë dhe Pogradec.





Seksioni 3: Strategjia e Programit

Strategjia njih prioritetet e kominikuara nga Palët e prekura (sseksioni 2.2), të cilat më pas janë fi ltruar dhe shqyrtuar nga Strukturat Operative për bashkëpunim ndërkuftar dhe Grupi i Përbashkët Punues përgjegjës për arritjet e programit si rrjedhim zbaton parimet e **kordinimit**. Janë bërë zgjedhje strategjike për parimet e përgjithshme të mëposhtme:

Pajtueshmëri - prioritetet tematike nuk janë ndryshuar dhe janë të përcaktuara në Aneksin III të Rregullores IPA II dhe dokument përkatës strategjik shumë-vendase;

Partneritet - janë zgjedhur prioritetet e duhura bazuar në reagime nga organizatat që përfaqësojnë autoritetet publike rajonale, lokale, urbane dhe të tjera, partnerët ekonomik dhe social dhe partnerët e shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit, shoqata civile dhe organizatat përgjegjëse për promovimin e barazisë;

Fokus - Strategjia e siguruar në fokusin e duhur dhe efektiv për burimet e kufizuara dhe ndërhyrjes është bazuar në detajet sociale dhe ekonomike të zonës së mbuluar nga programi, i cili fokusohet në tema dhe objektiva të zgjedhura dhe mat rëndësinë themelore të kohezionit socio-ekonomik dhe zhvillimin e dëshiruar;

Pajtueshmëri me Programin Kombëtar - Programi plotëson dhe rrit strategjitë kombëtare të përcaktuara në Dokumentin e Strategjisë së Vendit me mbështetjen e bashkëpunimit rajonal dhe territorial.

3.1 Sqarim – arsyetim i strategjisë së zgjedhur për intervenim

Përmbajtja e strategjisë së propozuar del nga:

1. Situata dhe SWOT analiza;
2. Problemet e identifi kuara dhe mundësia strategjike dhe
3. Rradhitja e Prioriteteve Tematike sipas rëndësisë së tyre rreth zonës së përfshirë me Programin: Nxitje e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore, Përmirësim i konkurrencës, ekonomisë, tregtisë dhe investimeve, Mbrojtja e mjedisit jetësor, avancim i përshtatjes së ndryshimeve klimaterike dhe migrimit, mbrojtje nga menaxhimi me rrezik.



Zhvillimi socio-ekonomik i balancuar, përfshirës dhe të qëndrueshëm në zonën kufitare është i stimuluar me misionin e programit dhe objektivin e tij kryesor, duke pasur parasysh perspektiva afatmesme të ndërhyrjes së propozuar.

Programi synon në sinergji me **Qëllimet specifike IPA II dhe dokumentet strategjike të vendit** në drejtim të: mbështetjes në zhvillimin e shoqërisë civile, dialogun social, nxitjen e punësimit dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor, përfshirjen sociale dhe ekonomike dhe bashkëpunimit territorial.

Tabela 1: Shqyrtim sintetik i arsytimit të zgjedhjes së prioriteteve tematike

Prioritete të përzgjedhura tematike	Arsyetim për përzgjedhjen
Nxitje e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore (Rregullorja TP4IPA II)	Bazuar në mundësitë e identifikuara strategjike që lidhen me rritjen e rëndësisë së turizmit si një mundësi ekonomike ndërsa nxitjen e shkëmbimit kulturor dhe promovimin e trashëgimisë natyrore do të mbajë dialogun ndërmjet njerëzve dhe shoqërisë civile, nga njëra anë dhe institucioneve nga ana tjetër.
Përmirësim i konkurrencës, ekonomisë, tregtisë dhe investimeve (Rregullorja TP7IPA II)	Synon të adresojë norma të ulëta të punësimit në zonën e mbuluar nga Programi. Kjo do të preket nga përmirësimi i qasjes në tregje, rritjes së përdorimit të veglave TIK, duke përfshirë e – tregtinë, dhe shfrytëzimin më efikas të mundësive të ofruara nga zinxhiri i vlerës në zonën kufitare.
Mbrojtja e ambientit jetësor, avancim i përshtatjes së ndryshimeve klimaterike dhe migrimit, mbrojtje nga menaxhimi me rrezik (Rregullorja TP2IPA II)	Synon të përmbushë nevojat specifike të njëres nga zonat më të neglizhuara të përfshirjes. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar kjo do të merret me çështjet e promovimit sa më të pastër dhe ekonomisë së gjelbër, përdorim më të përgjegjshëm dhe më të qëndrueshëm të burimeve natyrore, fleksibilitet të klimës, mbështetje të infrastrukturës (kundër përmytjeve dhe zjarreve në pyje) dhe erozionin e tokës në zonën malore të kufijve.

Asistenca teknike ofron menaxhim të mirë me Programin gjatë zbatimit të tij dhe zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve relevantë në Program. Alokimi financiar për këtë prioritet është 10% nga buxheti i programit.



Alokimi buxhetor indikativ për Prioritetet Tematike është konsensus midis parimit për **fokusim** të kombinuar me një shpërndarje të balancuar të mjeteve. Gjithashtu i është kushtuar vëmendje intensitetit të kapitalit të projekteve të mundshme dhe renditjes aktuale të prioriteteve tematike ku turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore kanë qenë tema më të favorshme për mbështetje.

Prioritet	Shpërndarje e buxhetit (%)
1. Nxitje e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore (TP4)	31,5
2. Përmirësim i konkurrencës, ekonomisë, tregtisë dhe investimeve (TP7)	31,5
3. Mbrojtje e ambientit jetësor, avancim i përshtatjes së ndryshimeve klimaterike dhe migrimit, mbrojtje nga menaxhimi me rrezik (TP2)	27,0
0. Asistencë teknike	10,0
TOTALI	100

Parimi i **rritjes gjithëpërfshirëse, të arsyeshme dhe të qëndrueshme njihet si çështje ndër sektoriale** dhe zbatohet për të gjitha prioritetet tematike të Programit dhe objektivat e tyre.


Strategjia e propozuar, njashtu, **bazohet te konstatimet dhe rekomandimet kyçe nga draft-raporti për vlerësim të bashkëpunimit ndërkuftar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë** për periudhën 2007-2014.

3.2 Përshkrim i prioriteteve tematike të Programit

Përshkrim i çdo prioriteti tematik është rregulluar në formën e një liste pune për përmbajtjen dhe strukturën e ngjashme me ndonjë prioritet, ndërsa prioriteti për asistencën teknike ka përmbajtje të veçantë.

Numërimi i prioriteteve tematike të Programit është dhënë në mënyrë të renditur sipas prioriteteve tematike, të llogaritura gjatë ushtrimit të programit në lidhje me një numërim të veçantë të prioriteteve tematike të përcaktuara në Rregulloren IPA II.

Shifrat e prezantuara më poshtë tregojnë pikërisht këtë program të ndërhyrjes logjike dhe mbivendosjen e prioriteteve individuale ndër sektoriale dhe çështjet horizontale.



Pasi perspektiva e programit 2014-2020 është më e orientuar në rezultate se sa në vetë strukturën IPA 2007-2013, të gjithë treguesit e rradhitur në fletët e punës më poshtë kanë për qëllim që të sigurojnë informacion në lidhje me operacionet dhe projektet që duhet ta mbështesin. Ata do të kontribuojnë te indikatorët për të përcaktuar programin.

Përbajtja e ndërhyrjes e përshkruar më poshtë, konsideron vërejtjet dhe komentet konstruktive të bëra gjatë ngjarjeve të konsultimit publik të mbajtura në zonën e mbuluar nga programi në periudhën dhjetor 2013 - mars 2014.

Prioriteti tematik 1: Nxitje e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore (TP4)

Shqyrtimi dhe referenca strategjike e prioritetit tematik

Europa është destinacioni numër një turistik në turizmin kulturor të botës dhe shumë qytete të mëdha, si dhe ka një rrjedhë të vizitorëve ndërkombëtarë dhe vendas. Politikat turistike do të duhet të përshtaten me këto trende dhe të zhvillohet një ofertë e cilësisë që do të promovojë kulturat dhe traditat lokale



dhe do të përkushtojnë vëmendje për aspekte të qëndrueshëm: si mbrojtja e trashëgimisë, mjedisit dhe kulturës. Zona lokale e mbuluar nga programi ka për qëllim të jetë e përfshirë nga mundësitë strategjike që dalin nga potenciali më i gjerë i kontinentit, i cili është në përputhje me konceptin e turizmit të qëndrueshëm dhe kulturor, të promovuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Ndërmarrje dhe Industri.

Turizmi është një nga mundësitë ekonomike prioritare që janë në interes të popullatës së bashkëpunimit ndërkufitar. Edhe pse industria hotelierike është e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në zonën e mbuluar nga programi, ajo është në rritje në të dy vendet. Aktualisht, aktivitetet turistike janë burimi kryesor i të ardhurave për popullatën në rajonin e Ohrit dhe të Prespës, në muajt e verës, por ka një potencial të pashfrytëzuar për zhvillimin e kulturës, aventurës dhe të turizmit më të qëndrueshëm në rajonin e bashkëpunimit ndërkufitar.

Bashkëpunimi në mes të institucioneve të ndryshme dhe organizatave në rajonin e bashkëpunimit ndërkufitar është në rritje, por ekziston një mungesë e ndërmarrjeve të qëndrueshme të përbashkëta të përmasave të mëdha. Aktivitetet e përfshira në këtë prioritet tematik, gjithashtu mbështesin bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të bazuara në vlerësimin e ofertës heterogjene dhe potencialin e kulturave të ndryshme dhe traditave të pranishme në zonë dhe ndërveprimet e tyre reciproke. Ata duhet të kontribuojnë në trajtimin e sfidave të tilla si mbrojtja e burimeve natyrore dhe kulturore, duke promovuar mirëqenien e komuniteteve lokale, përmirësimin e cilësisë së vendeve të punës në turizëm, kufizimin e ndikimit që turizmi e ka në mjedis, dhe është e lidhur për transportin etj.

Qëllimi specifik

Qëllimi specifik i këtij prioriteti tematik ka tendencë në **zhvillimin e potencialit të turizmit me promovimin e trashëgimisë kulturore dhe vlerave** (SO 1.1).

Prioritetet tematike do të inkurajojnë larinë e shërbimeve turistike të furnizimit dhe produkteve. Duke mbështetur projekte që promovojnë program të qëndrueshëm të produkteve turistike tematike do të forcohet bashkëpunimin transnacional mbi turizmin e qëndrueshëm, do të inkurajohet përfshirja më e madhe e ndërmarrjeve të vogla dhe atyre mikro, dhe autoritetet vendore do të stimulojë konkurrueshmërinë e industrisë së turizmit përmes rritjes duke u fokusuar në shumëllojshmërinë e produkteve të qëndrueshme tematike e kulturore të turizmit. Prioritetet Tematike, gjithashtu kanë për qëllim të përmirësojnë aftësitë e stafit të hotelierisë, duke përfshirë trajnimin profesional për mungesën e aftësive për një lloj të ndryshëm të ofertës turistike, për shembull, udhëheqësve turistik dhe trajnerëve të specializuar në sportet e dimrit, sportet malore, turizmin rural dhe aventurën, stafin e shërbimeve hoteliere etj.



Rezultatet e pritura

Ky prioritet tematik ka për qëllim realizimin e rezultateve të mëposhtme:

- 1.1.1 Rritje e mundësive afariste për ofertuesit lokal të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit dhe
- 1.1.2 Avancim të bashkëpunimit të ndërsjellë, kuptueshmëri dhe respekt ndaj trashëgimisë kulturore dhe vlerave.

Prioriteti tematik 2: Përmirësimi i konkurrencës, ekonomisë, tregtisë dhe investimeve (TP7)

Shqyrtimi dhe referenca strategjike e prioritetit tematik

Papunësia e lartë, normat e ulëta të punësimit dhe vlera e shtuar e ekonomisë në zonën e mbuluar nga programi është çështje që është duke shkaktuar shqetësim serioz. Prandaj, promovimi, qëndrueshmëria dhe krijimi i vendeve të punës dhe burimeve alternative të të ardhurave është një nga politikat kryesore për zhvillimin socio - ekonomik në rajonin e bashkëpunimit ndërkufitar në këto rrethana.

Prioriteti tematik synon të mbështesë qasjen e tregut të operatorëve ekonomik në të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë në zonën e mbuluar nga programi, duke rritur përdorimin e mjeteve dhe teknologjitë të TIK dhe përfshirjen e mundësive të pashfrytëzuara të zinxhirit të vlerës, duke përfshirë ato në ekonominë rurale. Ata pritet të kontribuojë në rritjen e aftësisë konkurruese, zhvillimin e tregtisë së re dhe investimeve në zonën e mbuluar nga Programi.

Qëllimi i aktiviteteve të këtij prioriteti tematik është për të adresuar mundësitë strategjike dhe numrin e kufizuar që lidhen me konkurrencën, e cila mbetet një nga shtyllat kryesore të Strategjisë Evropë 2020. Fushëveprimi i ndërhyrjes së propozuar është plotësisht në përputhje me IPA II qasjen sektoriale: Zona Politika A - Procesi i tranzicionit dhe ndërtimi institucional, sektor: Zhvillimi i sektorit privat dhe qëllimi tematik 3 nga Fondet Strukturore për ndërhyrje: Konkurenca e SMV.

Qëllimi specifik

Ky prioritet tematik fokusohet në **përforcimin e kapacitetit produktiv të SMV dhe qasjes në tregje** (SO 2.1).

Ndërhyrja do të përqendrohet në rritjen e ndërgjegjësimit për mundësitë që dalin nga zinxhiri ekzistues i vlerave ekonomike, për të mbështetur certifi kimin e cilësisë së produkteve dhe proceseve të nevojshme për tregjet ndërkombëtare dhe rritjen e përdorimit të pajisjeve moderne për shitje, duke përfshirë e-tregtinë. Me qëllim për të stimuluar ekonominë rurale dhe mundësitë e saj strategjike do të zhvillojë një fushatë për hapjen/zhvillimin e tregjeve për prodhime të freskëta.



Rezultatet e pritura

Rezultati i prituri i lidhur me konkurrencën ka për qëllim prioritetin ekonomik të:

- 1.1.1 Rritjes së ndërgjegjësimit dhe kapacitetit të SMV dhe sipërmarrjeve të reja për përfshirje të tregjeve të reja dhe zinxhirit të vlerave.

Prioriteti tematik 3: Mbrojtje e ambientit jetësor, avancim i përshtatjes së ndryshimeve klimaterike dhe migrimit, mbrojtje nga menaxhimi me rrezik (TP2)

Shqyrtim i referencës strategjike të prioritetit tematik

Zona e mbuluar nga Programi karakterizohet nga një mjedis të pasur dhe të ndryshëm si dhe natyror dhe në përgjithësi një territor i pastër dhe i gjelbër. Megjithatë, rajonit i mungon infrastruktura për mbrojtjen e mjedisit, strategjitë dhe praktikatat për njohjen e hershme, parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut. Zona Kufitare është e prirur për mot të ligë dhe fenomene të dukurive klimaterike, veçanërisht me stuhi të mëdha dhe shira që rezultojnë me përmbytje lokale dhe rrëshqitje të tokës, dëmtim të rrugëve, pronës private dhe të tokës bujqësore. Gjatë thatësirës, zjarret në pyje shkatërrojnë ekonominë rurale dhe të lashtat. Kushtet e motit janë një nga çështjet që duhet të diskutohen nga ky prioritet tematik.

Për më tepër, duke pasur parasysh përmirësimet në mbledhjen e mbeturinave të ngurta, menaxhimin e mbeturinave dhe trajtimin si dhe praktikatat parandaluese për erozionin e tokës si fusha prioritare të ndërhyrjes në rajon për bashkëpunim ndërkufitar.

"Për të jetuar mirë në kufijtë e planetit tonë", është titulli kryesor i programit të ri të veprimit për mjedisin 2020, i cili duhet të propozohet nga Komisioni. Ky prioritet tematik i bashkëpunimit ndërkufitar është ndërtuar mbi bazën e këtij titulli dhe është në përputhje me IPAII politikatat - Zona B: Departamenti i Zhvillimit Rajonal: Mjedisit dhe ndryshimet klimatike dhe qëllimet tematike 5 dhe 6 të fondeve strukturore për ndërhyrje: Promovimin dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, mbrojtjen dhe menaxhimin e rrezikut dhe mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e efikasitetit të burimeve.

Aktivitetet e prioritetëve tematike përfshijnë "projekt të butë", që ka pasur për qëllim rritjen e vetëdijes dhe nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve, ekonomi të gjelbër, dhe mbështetjen e investimeve të vogla në infrastrukturë për mbrojtjen e mjedisit, që vlerësohen të kenë një ndikim të rëndësishëm në bashkëpunimin ndërkufitar dhe për të krijuar një efekt demonstrues. Ndërhyrja kërkon gjithashtu të adresohen kapacitetet e ulët të financiar dhe institucional të shërbimeve publike dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe metodat e prodhimit bujqësor.



Qëllimi specifik

Është rritur ndërgjegjësimi për një ekonomi më të gjelbër, një ambient më të pastër jetësor dhe ndryshime klimaterike, ky është titulli për objektivin konkret të këtij prioriteti tematik (SO 3.1).

Prioriteti tematik ka një dimension të shpërndarë për të cilin duhet qasje e bazuar në vend ngase territore të caktuar ndërkufitare ndahen dhe do të fokusohet në krijimin e ndërgjegjësimit dhe njohurive, integrimin të komuniteteve dhe grupeve të objektivit, si dhe zbatim të masave reale për zgjidhje të çështjeve të nënvizuara në pjesën e mësipërme. **Një fokus i veçantë do ti drejtohet përpunimit të drurit për ndërtim nga pyjet dhe furnizimit me ujë.**

Rezultatet e pritura

Ky prioritet tematik ka për qëllim realizimin e rezultateve si më poshtë:

- 1.1.1 Ndërgjegjësim dhe njohuri rreth qëndrueshmërisë së përdorimit të resurseve natyrore dhe mjedisit jetësor dhe
- 1.1.2 Ndërhyrje të infrastrukturës publike që është vulnerabil ndaj përmblytjeve, erozionit të tokës dhe zjarreve.

Asistenca teknike

Objektivi specifik i asistencës teknike është që të sigurojë zbatimin efikas, efektiv, transparent dhe në kohë të bashkëpunimit ndërkufitar, dhe për të rritur ndërgjegjësimin e programit mes komuniteteve kombëtare, rajonale dhe lokale dhe popullatës në përgjithësi në zonën e mbuluara nga Programi. Gjithashtu, mbështet aktivitetet për të rritur ndërgjegjësimin e nivelit të vendit me qëllim të informimit të qytetarëve në të dy vendet përfituese IPA II. Për më tepër, siç ka treguar përvoja e Programit 2007-2013, prioritetet do të forcojnë kapacitetet administrative të autoriteteve dhe përfituesëve nëpërmjet zbatimit të programit në drejtim të përmirësimit të pronësinë dhe qëndrueshmërinë e programit dhe rezultatet e projektit.

Shpërndarja e asistencës teknike do të përdoret për të mbështetur punën e Strukturave Operative kombëtare dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (KPM) në sigurimin e vendosjes efektive, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe shfrytëzimin optimal të resurseve. E gjithë kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit dhe punës së Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT) në Republikën e Maqedonisë dhe Antenës në Republikën e Shqipërisë. SPT do të



jetë përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të programit dhe do të raportojë deri tek SO-ve dhe KPM-së.

Rezultatet e pritura:

Kritje e mbështetjes administrative e strukturave operative dhe Komitetit të përbashkët për monitorim të Programit.

Ky prioritet do të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të programit në të gjitha fazat e tij. Kjo përfshin disponueshmërinë e fondeve dhe alokimin e personelit të kualifikuar përgjegjës për të ndihmuar strukturat operative dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit, si dhe krijimin dhe zbatimin e mekanizmave dhe procedurave për menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin. Nëse është e nevojshme, do të kontribuojë në përgatitjen e ciklit të mëvonshëm financiar (2021-2027).

Seksioni 4: Plani financiar

Tabela 1 tregon shumën indikative vjetore të kontributit të UE të bashkëpunimit ndërkufitar në miliona euro për periudhën 2014-2020. Tabela 2 tregon ndarjen indikative të fondeve sipas prioritetit tematik në miliona euro, si dhe një tregues të shumës maksimale të bashkë-financimit nga UE.

Viti	Programi për bashkëpunim ndërkufi tar mes Republikës së Maqedonisë – Shqipërisë nga IPA II							Totali (EURO)
	(EURO)	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014-2020
Operacione nga BNK (të gjitha prioritetet tematike)	1190000	1700000	1700000	1190000	1700000	1700000	1530000	10710000
Asistenca teknike	510000	0.00	0.00	510000	0.00	0.00	170000	1190000
Totali (EURO)	1700000	1700000	1700000	1700000	1700000	1700000	1700000	11900000

Tabela 1: Mjete financiare indikative në nivel vjetor për Programin e bashkëpunimit ndërkufitar për 2014-2010



PRIORITETE	Programi për bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë – Shqipërisë 2014-2020 nga IPAII			
	Kontribut nga UE-ja	Bashkëfi nancim nga përfituesit	Totali i fondeve	Norma e kontributit nga UE-ja
	(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	(d) = (a)/(c)
1 Prioritet tematik – Nxitje e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore	3750000.00	661764.71	4411764.71	85%
2 Prioriteti tematik – Përmirësimi i konkurrencës, ekonomisë, tregtisë dhe investimeve	3750000.00	661764.71	4411764.71	85%
3 Prioriteti tematik – Mbrojtja e ambientit jetësor, avancimi i përshtatjes së ndryshimeve klimatike dhe migrimit, mbrojtje nga menaxhimi me rrezik	3210000.00	566470.58	3776470.58	85%
4 – Asistenca teknike	1190000.00	0.00	1190000.00	100%
SHUMA TOTALE	11900000.00	1890000.00	13790000.00	

Tabela 2: Mjete financiare indikative sipas prioritetit për periudhën 2014-2020 dhe norma e kontributit e UE-së

Kontributi i UE në lidhje me llogaritjen e shpenzimeve të kualifikuara, të cilat bazohen në totalin e shpenzimeve të lejueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private.

Shkalla e bashkëfinancimit të nivelit të UE për secilin prioritet tematik nuk do të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve totale.

Bashkëfinancimi i prioriteve tematike do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e granteve duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të totalit të shpenzimeve të lejueshme.

Një sasi e caktuar e asistencës teknike është e kufizuar në 10% të shumës totale të ndarë për programin. Shkalla e bashkëfinancimit e UE do të jetë 100%.

Fondet për prioritetet tematike do të transferohen nga Komisioni për zbatimin e vendimeve, duke mbuluar mjetet për një deri në tre vjet, sipas rastit. Fondet për asistencë teknike do të transferohen me Vendim të Komisionit për Zbatim.



Seksioni 5: Strukturat e menaxhimit të Programin

5.1 Struktura Organizative në nivel kombëtar

NIPAK vendet pjesëmarrëse mbajnë përgjegjësi të përbashkët për të siguruar që objektivat e parashikuara në programet e propozuara të bashkëpunimit ndërkufitar janë në përputhje me qëllimet e dokumenteve strategjike IPA II.

Në Maqedoni, zëvendëskryeministri për çështje europiane është emëruar si koordinator kombëtar për IPA dhe vepron si përfaqësues i vendit vis-à-vis Komisionit. Koordinator kombëtar IPA ka emëruar zonjën, Mjellma Mehmeti-Petersen koordinator për bashkëpunim ndërkufitar. Në Shqipëri, koordinator kombëtar për IPA është Ministri për Integrim Europian.

5.2 Struktura operative

Strukturat operative do të krijohen brenda administratës së secilit vend pjesëmarrës në zhvillimin, zbatimin dhe menaxhimin e programeve për bashkëpunim ndërkufitar. Ato janë:

Republika e Maqedonisë

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale

Republika e Shqipërisë

Ministria e Integritimit Europian

5.3 Organi kontraktues

Organi kontraktues është Unioni Europian në Republikën e Maqedonisë.

Republika e Maqedonisë

Delegacioni i Unionit Europian

5.4 Komiteti i përbashkët i monitorimit (KPM)

Komiteti i Përbashkët i Monitorimit është organi i cili merr vendimet për programin ndërkufitar dhe është përgjegjës për monitorimin më efektiv dhe cilësor për zbatimin e programit. KPM është i përbërë nga përfaqësues të koordinatorëve kombëtarë IPA për bashkëpunim territorial, sipas rastit, përfaqësuesve të vendeve pjesëmarrëse (autoriteteve kombëtare, rajonale, lokale), duke përfshirë edhe strukturat operative për bashkëpunim ndërkufitar dhe ku është e nevojshme, palëve tjera të tilla si organizatat e shoqërisë civile. Komisioni do të merr pjesë në KPM në cilësinë e trupit këshillues.



5.5 Sekretariati i Përbashkët Teknik/Antena

Sekretariati i Përbashkët Teknik - Strugë (SPT) do të asistoj Komitetitn, strukturat operative dhe KPM-në. SPT do të menaxhohet nga të dyja Strukturat Operative.

SPT ndodhet në Strugë, Republika e Maqedonisë, dhe ka Antenë në Elbasan, Shqipëri.

Sekretariati i Përbashkët Teknik është organi administrativ i programit përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të programit.



Broshura është përgatitur në kuadër të projektit
"Asistencë teknike Ministria e Vetëqeverisjes Lokale për implementimin e programit për
bashkëpunim ndërkufi tar me Shqipërinë" IPA/2013/333-498

Organi i zbatimit:

Republika e Maqedonisë
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
"Shën Kirili dhe Metodi" 54
1000 Shkup
Tel. (+389 2) 3253 921
Faksi: (+389 2) 3253 920
www.mls.gov.mk

Republika e Shqipërisë
Ministria e Integritimit Europian
Bul. Dëshmorët e Kombit
Sheshi Nëna Terezë, nr 1010, Tiranë
Tel. (+355 4) 2228 623
Faksi: (+355 4) 2228 623
www.mie.gov.al

Organi kontraktues:

Republika e Maqedonisë
Delegacioni i Unionit Europian
"Shën Kirili dhe Metodi" 52b
1000 Shkup
Tel. (+389 2) 3248 500
Faksi: (+389 2) 3248 501

Trupi administrativ i programit:

Sekretariati i Përbashkët Teknik Strugë
rr. "Boro Duni"
6330 Strugë
Tel. (+389 46) 788 300
Faksi: (+389 46) 701 735

Antena Elbasan
Lagjja "Brigada 17 S"
Rr.11 Nëntori, Prefektura Elbasan, kati 3
Tel. (+355 4) 244 431
(+355 69) 2245 430

www.ipacbc-mk-al.net

Shkup, Prill 2015